

Nr. Prot. 5213

Datë: 12.12.2016

**Lënda:** Kërkesë për informacion

**Dërguar:** Znj. Romina Mustafaraj  
Administratore  
Njësia Administrative Kutë

**Baza ligjore:** Neni 28, 48 dhe 56 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
Neni 51- 55, Ligjit Nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;  
Neni 3 Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;  
Neni 13, Ligji Nr. 10431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”

E nderuar Znj. Mustafaraj,

Në vazhdim të korrespondencës mbi marrjen e informacionit në lidhje me procedurën e ndjekur për dhënien e koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit të Poçemit, EcoAlbania (Qendra për Ruajtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri), po mbledh informacion nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore të cilat preken nga ky hidrocentral.

Pas vërtetimit të lëshuar nga institucioni juaj me dt.10.11.2016 dhe nr. 35 prot. rezulton se asnjë nga pjesëmarrësit në konsultimin publik për lëshimin e Deklaratës Mjedisore për hidrocentralin e Poçemit nuk është banor i Njesisë Administrative Kutë. Ne duam të vërtetojmë nëse kjo ka ardhur si pasojë e mos informimit apo e mos interesimit të publikut.


Për sa më sipër ne kërkojmë informacion nëse institucioni juaj është informuar në rrugë zyrtare për këtë konsultimin me publikun, të zhvilluar më datë **28.02.2015**, në “Hotel Fieri” në Fier.

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin,

Me respekt,



Olsi Nika  
Drejtore Ekzekutive





RËPUBLIKA Ë SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
NJËSIA ADMINISTRATIVË KUTË

Nr 252 prot

Kutë, më 16/12/2016

**Lënda:** Kthim përgjigje

**Drejtuar:** Eco Albania

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr 52/3 prot. datë 12.12.2016 'Kërkesë për informacion' ju bëjmë me dije se për periudhën 10.08.2015 deri në 16.12.2016 nuk ka mbërritur asnjë shkresë zyrtare në Njësinë Administrative Kutë ku te përcillej informacion në lidhje me konsultimin me publikun.

Po ashtu në bazë të kontrollit të ushtruar në zyrën e arkivit në Njësisë Administrative Kutë për afatin kohor nga 01.01.2015 - 31.03.2015 nuk rezulton të ketë shkresë të mbërritur në ish-komunën Kutë lidhur me këtë çështje.

*Në mirëkuptim dhe bashkëpunim më ju !*

P/Z ARKIVIT

Qatip SALAJ

ADMINISTRATOR

Romina MUSTAFARAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MALLAKASTËR**  
KRYETARI

Adresa: Lagjia "18 Prilli", Ballsh, Mallakastër, Tel: +355 313 22 113

Nr. 2007/4 Regj.

Ballsh, më 15/12/2016

Lenda: Kthim Përgjigje/ Informacion Lidhur me planin e nderdimit të HEC-Poçem

**Drejtuar: Eco, Albania**

NR. 11/16

*I nderuar Zoti Nika,*

Bashkia Mallakastër është duke ndjekur me shqetësim planin për ndërtimin e HEC- Poçem, Mallakastër. Shqetësimi jonë bazohet në ankesat e banorëve të zonës të cilët preken, në rast të ndërtimit të Hidrocentralit. Banorët kanë shprehur shqetësimet e tyre pranë institucionit tonë lidhur me problematikën që shoqëron ndërtimi i këtij HEC-i.

Bashkia Mallakastër nuk është njoftuar në rrugë zyrtare për konsultim publik më datë 28/02/2015, ashtu si parashtrohet në shkresën tuaj datë 12/12/2016. Po kështu Institucioni jonë nuk është njoftuar apo kontaktuar për asnjë konsultim tjetër publik lidhur me ndërtimin e HEC- Poçem. Në territorin e Bashkisë Mallakastër nuk është kryer asnjë takim me banorët apo me Institucionin tonë lidhur me Deklaratën Mjedisore apo ndonjë konsultim tjetër lidhur me transparencën e ndërtimit të HEC- Poçem.

Bashkia Mallakastër është e interesuar për të mbështetur dhe përcjeli të gjitha kërkesat dhe ankesat e ligjshme të banorëve, për transparencën e këtij projekti, dhe të gjenerojë informata të cilan prekin popullatën dhe territorin nën juridiksionin tonë.



**KRYETARI**  
**Agron KAPLLANAJ**

Nr. Prot. 52/1

Datë: 12.12.2016

**Lënda:** Kërkesë për informacion

**Dërguar:** Z. Agron Kapllanaj  
Kryetar i Bashkisë  
Bashkia Mallakastër

**Baza ligjore:** Neni 28, 48 dhe 56 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
Neni 51- 55, Ligjit Nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;  
Neni 3 Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;  
Neni 13, Ligji Nr. 10431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”

I nderuar Zoti Kapllanaj,


Në vazhdim të korrespondencës mbi marrjen e informacionit në lidhje me procedurën e ndjekur për dhënien e koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit të Poçemit, EcoAlbania (Qendra për Ruajtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri), po mbledh informacion nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore të cilat preken nga ky hidrocentral.

Pas vërtetimit të lëshuar nga institucioni juaj me dt. 17.11.2016 dhe nr. protokollit 2007/2 rezulton se asnjë nga pjesëmarrësit në konsultimin publik për lëshimin e Deklaratës Mjedisore për hidrocentralin e Poçemit nuk është banor i Bashkisë Mallakastër. Ne duam të vërtetojmë nëse kjo ka ardhur si pasojë e mos informimit apo e mos interesimit të publikut.

Për sa më sipër ne kërkojmë informacion nëse institucioni juaj është informuar në rrugë zyrtare për këtë konsultimin me publikun, të zhvilluar më datë **28.02.2015**, në “Hotel Fieri”.

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin,

Me respekt,

  
Olsi Nika  
Drejtor Ekzekutiv



Nr. Prot. 52/2

Datë: 12.12.2016

**Lënda:** Kërkesë për informacion

**Dërguar:** Z. Përparim Shameti

Kryetar i Bashkisë

Bashkia Selenicë

**Baza ligjore:** Neni 28, 48 dhe 56 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
Neni 51- 55, Ligjit Nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;  
Neni 3 Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;  
Neni 13, Ligji Nr. 10431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”

I nderuar Zoti Shameti,

Në vazhdim të korrespondencës mbi marrjen e informacionit në lidhje me procedurën e ndjekur për dhënien e koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit të Poçemit, EcoAlbania (Qendra për Ruajtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri), po mbledh informacion nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore të cilat preken nga ky hidrocentral.

Pas vërtetimit të lëshuar nga institucioni juaj me dt.17.11.2016 dhe nr. 2188 prot. rezulton se asnjë nga pjesëmarrësit në konsultimin publik për lëshimin e Deklaratës Mjedisore për hidrocentralin e Poçemit nuk është banor i Bashkisë Selenicë. Ne duam të vërtetojmë nëse kjo ka ardhur si pasojë e mos informimit apo e mos interesimit të publikut.


Për sa më sipër ne kërkojmë informacion nëse institucioni juaj është informuar në rrugë zyrtare për këtë konsultimin me publikun, të zhvilluar më datë **28.02.2015**, në “Hotel Fieri” në Fier.

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin,

Me respekt,

Olsi Nika

Drejtor Ekzekutiv





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA SELENICE**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE ZHVILLIMIT TE**  
**TERRITORIT**

Adresa: RR.Llambi Bombaj, prane spitalit Selenice, e-mail:bashkia.selenice@gmail.com

Nr 2394/1 Prot

Selenicë më 29.12.2016

**Lënda:** Informacion

**Drejtuar:** Eco Albania

**TIRANE**

Në përgjigje të kërkesës tuaj me Nr.52/2 Prot., datë 12.12.2016, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.2394 Prot., datë 14.12.2016, me objekt “ Kërkesë për informacion”, ju bëjmë me dije se: Së pari, bashkia Selenicë nuk ka dijeni në lidhje me mbledhjen që është zhvilluar në qytetin e Fierit dhe së dyti, nga ndërtimi i këtij hidrocentrali preken rreth 800 ha tokë bujqësore të cilat ndodhen në territorin e bashkisë Selenicë. Për sa u citua më sipër kërkojmë brenda të gjitha hapësirave ligjore pezullimin e mëtejshëm të punimeve për ndërtimin e këtij hidrocentrali pasi në rast të kundërt do të kete pasoja shumë të rënda për banorët e kësaj zone të cilët disponojnë tokat bujqësore.

*Duke ju falenderuar per bashkëpunimin dhe mirëkuptimin!*

**KRYETARI**

**FERIARIM SHAMETAJ**

